

Bachelor në **Studime Mjedisore** (180 ECTC, 3 vite akademike, me kohë të plotë)

### **Profili profesional**

Ky program studimi synon të japë njohuri formuese të përgjithshme bazë mbi çështje dhe fenomene mjedisore në nivel global duke bërë njëkohësisht interpretime në kontekstin Shqiptar. Mjedisi dhe problemet e tij janë në qendër të vëmendjes si në shkallë lokale ashtu edhe në shkallë globale. Garantimi i ekuilibrave për mirëfunksionimin e të gjithë sistemit mjedisor ka si kusht trajtimin e problemeve të tij nga eksperte të të gjitha niveleve të cilët të përdorin llogjikën ambientale në të gjitha ndërhyrjet e njeriut , nisur edhe nga fakti që ndjeshmëria ndaj problemeve të mjedisit është ende në nivele shumë të ulëta në Shqipëri.

### **Temat kryesore që trajton ky program studimi:**

- *Formim i përgjithshëm*  
Topografi; Edukimi Mjedisor; Ligj dhe Legjislacion Mjedisor; Gjeografi Urbane; etj.
- *Formim baze karakterizues*  
Shkenca e Tokës; Uji, Mjedisi Akuatik dhe Hidrologjia; Ajri, Atmosfera dhe Klimatologjia; Vlerësimi i Impaktit në Mjedis; Ekologjia; Menaxhimi Mjedisor; Planifikimi Mjedisor Urban; Toksikologjia dhe Ndotja etj.
- *Formim integruar*  
Matematikë; Aplikime kompiuterike në Mjedis dhe GIS; Hidraulike; Kimi; etj.

### **Mundësitë për punësim**

Sektorët kryesorë të punësimit përfshijnë:

- Sektori privat i kompanive apo studiove të konsulences e projektimit në fushën e mjedisit për të kryer punë të asistuar.
- Sektori publik: nivelin e qeverisjes vendore, duke filluar që nga bashkitë e komunat e deri tek qarku apo rajonet. Nivelin e qeverisjes qendrore;
- Institucionet kërkimore shkencore vendase dhe të huaja të cilat kanë për fokus kryesor fushën e mjedisit.

### **Plani Mësimor si më poshtë vijon:**

Plan Mësimor sipas tipeve të veprimtarive i programit të studimit

Bachelor në Studime Mjedisore

Fusha disiplinore	Veprimtari formuese	Kredite	Kredite total	Kredite (%)
A (formim baze i pergjithshem)	Topografi	3	33	18%
	Matematike	6		
	Shkencat e Tokes	6		
	Ekonomiks (Statistike)	3		
	Edukim Mjedisor	3		
	Kimi	6		
	Gjeometri dhe dokumentim grafik	6		
B (karakterizuese)	Mjedisi Akuatik	6	90	50%
	Klimatologjia	6		
	Zhvillim Rural dhe Agrar	6		
	Dendrologji	6		
	Planifikim Mjedisor	6		
	Toksikologjia dhe Ndotja Mjedisore	6		
	Inxhinieri Mjedisi (Hidraulike)	6		
	Plan Veprimi Strategjik	6		
	Teknologji dhe Infrastrukturë Qyteti 1	6		
	Teknologji dhe Infrastrukturë Qyteti 2	6		
	Vleresim Strategjik Mjedisor	6		
	Vleresim i Ndikimit ne Mjedis	6		
	Ekologjia (Biodiversiteti)	6		
	Analizë e Territorit dhe Vendbanimeve (Analiza Mjedisore)	6		
GjeoMjedis (Menaxhim Mjedisor Lokal)	6			
C (integruese)	Ligj dhe Legjislacioni Urban	3	21	12%
	Statistike	6		
	Politika Mjedisore	6		
	GIS 2	6		
D (me perzgjedhje)	Lendë me përzgjedhje 1	6	12	7%
	Lendë me përzgjedhje 2	6		
E (formuese plotesuese)	GIS	6	18	10%
	Metoda të Kërkimit Shkencor	3		
	CAD	6		
	Internship Profesional	3		
F (Pergatitja tezes)	Projekti Final - DIPLOMA	6	6	3%
	<b>TOTAL</b>	<b>180</b>	<b>180</b>	<b>100%</b>